

Në bazë të neni 10 paragrafi (1) dhe nënparagrafi 6 të Rregullores për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr.01- 3732 datë 29.7.2019, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën e 30-të mbajtur më 8.8.2022, në lidhje me Propozimin nr. 03-3033/1 datë 3.8.2022 për zbatimin e procedurës për kundërvajtje kundër Shoqërisë për tregësi dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup për shkelje në neni 143 nga LSHMAAV, miratoi si në vijim:

KONKLUZË

1. Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me nr. 11-2959/1 datë 27.7.2022 ndaj Shoqërisë për tregësi dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, përcaktoi shkelje të nenit 143 paragrafi (3) nga LSHMAAV.

2. Këshilli konkludoi se ndaj Shoqërisë për tregësi dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup të ngrihet procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente sepse nga mbikëqyrja u konstatua se operatori në fjalë i rrjetit publik të komunikimit elektronik që sipas njoftimit nga Agjencia për komunikim elektronik mund të kryejë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në paketën e tij programore nuk ka siguruaruar shërbimet programore të shërbimit publik transmetues gjegjësisht nuk kryen ritransmetim të shërbimeve programore "MRT 2", "MRT 3", "MRT 4" dhe "MRT 5" që bie në kundërshtim me nenin 143 paragrafi (3) nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Obligohet Sektori për çështje juridike të përgatisë Kërkesë për inicim (zbatim) të procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për operatorin në fjalë.

4. Kopije nga Konkluzioni të dorëzohet tek :

- Udhëheqësit e të gjithë sektorëve në Agjenci;
- Personit të emërua nga Agjencia, për udhëheqjen e lëndës sipas procedurës administrative ;-
- Njësisë për mbështetjen e punës së Këshillit në Agjenci;
- Sektori për mbështetje informative dhe çështje të përgjithëshme – arkivi i Agjencisë .

Nr. 02-3032/4
08.08.2022
Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetar i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v